



Republika e Kosovës

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO	
KOMUNA E VUSHTRISË - OPŠTINA VUČITRN	
Nr. / Br.	2403126
Nr. i sq. / Br. st.	-6-
Data: / Datum:	16.01.26
VUSHTPRI - VUČITRN	



Komuna Vushtri

DREJTORIA PËR KULTURË, RINI DHE SPORT

Bazuar në Rregulloren (KKV) Nr. 208-2020 për Dhënien e Dekoratave të datës 29.10.2020 të miratuar në Kuvendin Komuna të Vushtrisë, si dhe me qëllim të motivimit dhe përkrahjes së sportistëve, artistëve, aktorëve dhe përgjithësisht krijuesve të kulturës si dhe vullnetarëve rinorë të Komunës së Vushtrisë, duke përfshirë edhe gjithë kontribuuesit e këtyre fushave, Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport në Komunën e Vushtrisë, më datë 16 janar 2026 shpall:

KONKURS

Për përzgjedhjen e Më të Mirëve në këto kategori:

1. Sportist i Vitit 2025
2. Krijues i dalluar i artit dhe i kulturës
3. Vullnetar i dalluar rinor

KATEGORIA I

1. SPORTST I VITIT 2025

Bazuar në nenin 15 të Rregullores (KKV) Nr. 208-2020 për Dhënien e Dekoratave të datës 29.10.2020 të miratuara në Kuvendin Komuna të Vushtrisë për sportistët e dalluar të vitit 2025 do të ndahen këto Medalje:

- a. *Sportisti i vitit (për të rritur) në vlerë 600 euro*
- b. *Sportistja e vitit (për të rritur) në vlerë 600 euro*
- c. *Sportisti i vitit (për të rinj) në vlerë 500 euro*
- d. *Sportistja e vitit (për të rinj) në vlerë 500 euro*

Me mirënjohje të veçanta do të nderohen:

- Klubi sportiv më i suksesshëm,
- Trajneri më i mire,
- Referi më i mirë,
- Punëtori Sportiv,
- Gazetari Sportiv,
- Shpresa e vitit,
- Ndarja e mirënjohjeve për mediat për kontributin e dhënë në zhvillimin dhe masovizimin e sportit.
-

1. Sportist i vitit mund të shpallet ai sportist i cili:

- a) Ka paraqitje kulmore, cilësore dhe arritje të larta individuale apo me klub të nivelit: ndërkombëtar, kombëtar, shtetëror, rajonal apo komunal
- b) Klubi i cili është paraqitur të ketë arritur suksese gjatë vitit kalendarik 2023, në garat ndërkombëtare apo vendore.
- c) Të ketë paraqitje standarde dhe numër të madh të paraqitjeve me klub, të jetë anëtar/e e reprezentacionit të shtetit.
- d) Të jetë i disiplinuar, i sjellshëm në kuadër të klubit ku është i/e inkuadruar.

2. Klubi sportiv i vitit mund të shpallet:

- a) Klubi sportive i cili në arenën ndërkombëtare ka arritur suksese
- b) Klubi sportive i cili në arenën vendore ka arritje të larta
- c) Rangu i garave ku klubi sportive garon
- d) Masoviteti i garave
- e) Organizimi i klubit.

KATEGORIA II

2. KRIJUES I DALLUAR I ARTIT DHE I KULTURËS

Me qëllim të motivimit dhe përkrahjes së artistëve dhe krijuesve të fushave të ndryshme të kulturës si dhe të vlerësimit të kontributit dhënë gjatë vitit 2025, të të gjithë njerëzve të kulturës në Komunën e Vushtrrisë, me theks të veçantë përkrahjes së të rinjve, Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport do të ndaj çmime të veçanta për krijuesit e rinj, në fushat, si në vijim:

Artist i dalluar	300 euro
Krijues letrar i dalluar	300 euro
Muzikant i dalluar	300 euro
Lexues i dalluar	300 euro
Aktor i dalluar	300 euro

Me mirënjohje për kontributin e dhënë në fushën e kulturës do të nderohen personalitete të veçanta që kontribuan profesionalisht në zhvillimin e kulturës, por edhe për mbështetësit e jashtëm.

1. Artist i dalluar mund të shpallet ai artist i cili:

- Ka realizuar dhe ekspozuar vepra artistike, në ekspozita personale apo kolektive, brenda ose jashtë vendit.
- Dallohet për nivel të lartë artistik, origjinalitet dhe identitet krijues,
- Ka kontribuar në zhvillimin dhe promovimin e artit pamor
- Ka përfaqësuar denjësisht komunitetin ose institucionin kulturor,
- Është vlerësuar nga juritë profesionale, kritika e artit apo publiku,
- Ka realizuar ekspozita artistike në Komunën e Vushtrrisë

2. Krijues letrar i dalluar mund të shpallet ai krijues i cili:

- Ka arritje të larta individuale të nivelit ndërkombëtar, kombëtar, rajonal apo komunal në fushën e krijimtarisë letrare
- Ka botuar ose promovuar vepra letrare: (libër, përmbledhje poetike, tregime, roman, ese, dramaturgjia apo studim letrar).
- Ka kontribuar në pasurimin e kulturës dhe identitetit letrar shqiptar,
- Është vlerësuar pozitivisht nga kritika letrare apo juritë profesionale
- Nuk ka qenë fitues i çmimit “Pena e Artë”, të ndarë nga Komuna e Vushtrrisë (për të nxitur barazinë dhe hapësirën për krijues të tjerë).

3. Muzikant i dalluar mund të shpallet ai krijues i cili:

- a) Ka krijuar, interpretuar ose promovuar vepra muzikore.
- b) Dallohet për cilësi artistike dhe origjinalitet.
- c) Ka kontribuar në zhvillimin dhe promovimin e muzikës.
- d) Është vlerësuar nga juritë profesionale ose publiku.
- e) Është paraqitur në aktivitete të organizuara nga Komuna e Vushtrrisë në këndim apo me instrument

4. Lexues i dalluar mund të shpallet ai lexues i cili:

- a) Ka treguar interes dhe përkushtim të vazhdueshëm ndaj leximit;
- b) Ka kontribuar në promovimin e kulturës së leximit;
- c) Dallohet për pjesëmarrje aktive në aktivitete letrare ose bibliotekare.
- d) Është vlerësuar nga institucionet kulturore (biblioteka) të Komunës së Vushtrrisë

5. Aktor i dalluar mund të shpallet ai i cili:

- a) Ka realizuar role artistike gjatë vitit 2025.
- b) Dallohet për interpretim cilësor dhe profesionalizëm.
- c) Ka kontribuar në zhvillimin dhe promovimin e artit skenik.
- d) Është vlerësuar nga juritë profesionale ose publiku.
- e) Ka realizuar aktivitete në Komunën e Vushtrrisë

KATEGORIA III

3. VULLNETARËT E DALLUAR RINORË

Me qëllim të motivimit dhe përkrahjes së vullnetarizmit dhe vullnetarëve si dhe të vlerësimit të kontributit të të gjithë vullnetarëve në Komunën e Vushtrrisë, me theks të veçantë përkrahjes së të rinjve, Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport do të ndaj çmim të veçantë, si në vijim:

Vullnetar rinor i dalluar - 300 euro

1. Vullnetar rinor i dalluar i vitit 2025 mund të shpallet ai i cili:
 - a) Ka kontribuar aktivisht në aktivitete vullnetare.
 - b) Ka treguar përkushtim, përgjegjshmëri dhe iniciativë.
 - c) Ka ndikuar pozitivisht në komunitet dhe promovimin e vlerave rinore.
 - d) Është vlerësuar nga organizatorët e aktiviteteve vullnetare ose komuniteti.
 - e) Është i moshës 15 - 29 vjeç.

KRITERE TË PËRGJITHSHME:

Të drejt aplikimi për çmime dhe mirënjohje kanë të gjithë sportistët, artistët, aktorët, klubet, muzikantët, vullnetarët dhe përgjithësisht krijuesit dhe kontribuuesit e sportit, artit dhe kulturës që janë banorë të Vushtrrisë dhe që në mënyra të ndryshme kanë dhënë kontribut për zhvillimin e kulturës në Vushtri.

Nëse Komisionet për Shpalljen e Më të Mirëve të Vitit, vërejnë se në aplikacione ka informata të pa sakta do të kërkohen sqarime shtesë, dhe në rast se nuk do të ketë arsye të bindëse për informatat e dhëna Komisionet mbajnë të drejtën për të diskualifikuar secilin që ofron ato informata.

Nëse ndonjë sportist që ka arritje të mira dhe nuk është propozuar nga klubi, komisioni do të kërkojë nga klubi dhe institucionet tjera informata të tjera shtesë që të përfshijë në listë atë sportist.

Kriteret për sportistin dhe klubet sportive vlejné edhe me rastin e shpalljes së më të mirëve edhe te “Shpresat e Vitit”, “Punëtori Sportiv i Vitit”, “Trajneri i Vitit”, “Pedagogu i Vitit”, Gazetari Sportiv i Vitit.

Duke qenë se për Krijuesit e Artit dhe të Kulturës, si dhe për Vullnetarët ndahen çmime për herë të parë, nuk është kufizuar kontributi vetëm për vitin 2025, sikurse për Sportistët e Vitit, ndërsa në vitet e ardhshme do të aplikohet vetëm për kontributin njëvjeçar.

Të gjitha materialet (biografi, certifikata, vlerësime të ndryshme, dëshmi mbi arritjet dhe veprimtarinë) duhet të dorëzohen në arkiv në zarfe të mbyllura dhe hapen në mbledhjen e vlerësimit të propozimeve nga anëtarët e Komisioneve Vlerësuese.

Në pjesën e jashtme të zarfit, secili aplikues duhet të shënojë qartë se për cilën nga tri fushat aplikon, në mënyrë që zarfi të adresohet në komisionin përkatës.

Komisionit duhet t'i paraqiten Propozimet e kompletuara me arsyeime për secilin propozim të bërë, deri me datë **30.01.2026**

Inkurajojmë të gjitha klubet sportive, sportistët, aktorët, muzikantët, krijuesit letrarë, vullnetarët dhe të gjithë ata që kanë dhënë kontribut për fushën e kulturës, rinisë dhe sportit që të paraqesin veprimtarinë e tyre, sepse në këtë mënyrë na e bëjnë të mundur të vlerësojmë kontributin e tyre.

Vushtrri, 16 janar 2026

Medina Bunjaku

Drejtores e DKRS-së